



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS
DIVIZIONI JURIDIK**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 08.06.2022]

Drejtuar: “TMC Training Management Consulting” SHPK;

Adresa: Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga “Hamdi Shijaku”, Pallati 6/3, Kati I - rë, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-23949-04-04-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “ISO (Auditime, trajnime + ISO 27001)”;

Kohëzgjatja e kontratës: 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj.

Buletini i Njoftimeve Publike: 11.04.2022, Nr. 46.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “TMC Training Management Consulting” SHPK, me NUIS K81826007A;
- Oferta, në vlerën 87.750.000 (tetëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH.
2. BOE “EON IMPRESA” SRLS, me NUIS 02781970427 & “QA INTERNATIONAL” SH.A., me NUIS CHE395.273.466;
- Oferta, në vlerën 65.253.888 (gjashtëdhjetë e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH.
3. “CONSULTING & MANAGEMENT ALBANIA” SHPK, me NUIS K82206013U;
- Oferta, në vlerën 89.250.000 (tetëdhjetë e nëntë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH.
4. “Re/Born” SHPK, me NUIS L71309019P;
- Oferta, në vlerën 64.000.000 (gjashtëdhjetë e katër milion) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- BOE “EON IMPRESA” SRLS, me NUIS 02781970427 & “QA INTERNATIONAL” SH.A., me NUIS CHE395.273.466, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kriterin e kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës (vertetim ose fatura), pasi faturat e paraqitura në vlerën rreth 61,000 euro janë poshtë vlerës 40 % e fondit limit që prokurohet;

- Operoret Ekonomik nuk kane në zotërim certifikatave kundrejt standarteve ISO 9001:2015 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ISO 14001:2015 “Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”, ISO 45001:2018 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë”, ISO 50001:2018 “Sistemet e menaxhimit të energjisë”, ISO 27001:2013 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”, ose ekuivalente me to, për dhënie të shërbimeve të konsulencës menaxheriale.

Fakti që i disponon administratori nuk plotëson kriterin që ti zotërojë subjekti.

- Një pjesë e madhe e dokumentacionit është në gjuhë të huaj italiane dhe e papërkthyer para noterit në gjuhët e procedurës së prokurimit që është shqip apo anglisht.

Mosparaqitja e dokumentacionit në gjuhët e përcaktuara si gjuhë të procedurës së prokurimit përbëjnë kusht skualifikues të operatorit ekonomik.

- “CONSULTING & MANAGEMENT ALBANIA” SHPK, me NUIS K82206013U, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk plotëson kriterin e kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. (vertetim ose fatura), pasi kontrata e paraqitur nuk është për shërbime të ngjashme;

- Mungon certifikate ISO 50001:2018 “Sistemet e menaxhimit të energjisë”;

- Certifikimet lidhur me ISO e kërkuara për stafin dhe ekspertet janë të vitit 2018 pa afat vlefshmërie të përcaktuar;

- Nuk provohen eksperiencat e ekspertëve për jo më pak se 3 vite si trajner në fushat e kërkuara.

- “Re/Born” SHPK, me NUIS L71309019P, për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur sigurim oferte;

- Nuk ka paraqitur vërtetim xhiro të 3 viteve të fundit;

- Nuk plotëson kriterin për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë sa 40 % e fondit limit që prokurohet;

- Certifikimet lidhur me ISO e kërkuara për stafin dhe ekspertet janë të vitit 2018 me afat vlefshmërie 3 vite, pra janë jashtë afatit të vlefshmërisë;

- Nuk provohen eksperiencat e ekspertëve për jo më pak se 3 vite si trajner në fushat e kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik, shoqërinë “TMC Training Management Consulting” SHPK, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga “Hamdi Shijaku”, Pallati 6/3, Kati I - rë, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 87.750.000 (tetëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Pirro Vengu